

## **Njoftim**

Në datën **12.06.2023**, ora **13:35**, në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën Rr.“Ismail Qemali”, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, do të hidhet shorti për përcaktimin e trupit gjykues për gjykimin e kërkesëpadisë Nr.30 Regj.Themeltar, Datë 09.06.2023, me:

**Paditws:** Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

**I paditur:** Komisionit Qendror i Zgjedhjeve – KQZ.

**Objekti:** Ndryshimin e Vendimit nr.175, datë 06.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

1. Rinumërimin dhe Rivlerësimin e drejtë të votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore Bashkia Belsh si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Belsh, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i drejtë i votave;
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr.2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore Bashkia Belsh;
3. Ndryshimin e Vendimit të KSHZ nr.533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke pasqyruar ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkia Belsh, duke mos përfshirë rezultatin e qendrës së votimit nr.2565/01 IEVP Burgu Kosovë; si dhe
4. Shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar Bashkia Belsh të z. Bedri Qypi mbështetur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

**Tiranë, më 12.06.2023**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**